

MARRËVESHJE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

LIDHUR ME PROGRAMIN E KORPUSIT TË PAQES
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Republika e Kosovës (tash e tutje “Kosova”) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (tash e tutje “Shtetet e Bashkuara”) duke njohur rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët e të dobishëm ndërmjet të dy vendeve, pajtohen si në vijim:

NENI I

1. Shtetet e Bashkuara do të ofrojë aq Vullnetarë të Korpusit të Paqes sa mund t’i kërkojë Kosova dhe t’i miratojnë Shtetet e Bashkuara për të kryer detyra e rëna dakord reciprokisht në Kosovë.
2. Vullnetarët do të punojnë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të organizatave qeveritare dhe private në Kosovë, të përcaktuara nga Shtetet e Bashkuara dhe Kosova.
3. Shtetet e Bashkuara do t’iu ofrojnë trajnim Vullnetarëve që ata të mund t’i kryejnë detyrat e tyre në mënyrën më efektive të mundshme.
4. Kosova do ta bartë atë pjesë të shpenzimeve të programit të Korpusit të Paqes të bëra në Kosovë, siç mund të pajtohen Shtetet e Bashkuara dhe Kosova.

NENI II

1. Kosova do t’iu siguroj trajtim të barabartë Vullnetarëve dhe personave që punojnë me kontratë për Korpusin e Paqes, si dhe familjarëve e pronës së tyre; do t’iu siguroj atyre dhe pronës së tyre ndihmë dhe mbrojtje të plotë, duke përfshirë edhe trajtim jo më pak të privilegjuar sesa ai që përgjithësisht iu ofrohet shtetasve të Shteteve të Bashkuara që banojnë në Kosovë; si dhe do të informojë, do të këshillohet dhe do të bashkëpunojë plotësisht me përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta.
2. Kosova do t’i përjashtojë Vullnetarët nga të gjitha tatimet mbi pagesat që marrin për të përballuar shpenzimet e jetesës, mbi të ardhurat që rrjedhin nga puna e tyre me Korpusin e Paqes dhe mbi të ardhurat e fituara nga burime të tjera jashtë Kosovës; nga të gjitha tarifatat doganore apo detyrimet e tjera mbi pronën e tyre personale që sillet në Kosovë për përdorim vetjak; si dhe nga të gjitha taksat dhe tarifatat e tjera (përfshirë edhe taksën e imigracionit/vizave) përveç taksave për licencat. Kosova do t’iu japë Vullnetarëve leje

qëndrimi dhe vizë (përfshirë edhe vizë me shumë hyrje-dalje) pa asnjë pagesë apo detyrim shtesë.

NENI III

1. Shtetet e Bashkuara do të pajisin Vullnetarët, Përfaqësuesin e Korpusit të Paqes dhe stafin e Përfaqësuesit me sasi të kufizuara të pajisjeve dhe të furnizimeve, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme nga Shtetet e Bashkuara dhe Kosova për tu mundësuar Vullnetarëve të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive.
2. Kosova do t'i përjashtojë nga të gjitha taksat (përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar), tarifatat doganore dhe detyrimet e tjera të gjitha pajisjet, furnizimet dhe mallrat dhe shërbimet e tjera që janë sjellë apo janë blerë në Kosovë nga Shtetet të Bashkuara apo nga çdo kontraktues që financohet prej tyre, për përdorim sipas kësaj marrëveshjeje.

NENI IV

1. Për t'ua mundësuar Shteteve të Bashkuara që t'i përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova do të mirëpres një Përfaqësues të Korpusit të Paqes dhe stafin e këtij Përfaqësuesi (përfshirë punonjësit dhe personat që punojnë në bazë të një kontrate me Korpusin e Paqes të përcaktuar nga Përfaqësuesi i Korpusit të Paqes) dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët bashkëjetojnë me ta, si të pranueshëm në Kosovë. Pavarësisht nga dispozitat e çfarëdo marrëveshjeje tjetër, Kosova do t'i përjashtojë këta persona dhe anëtarët e familjeve të tyre që bashkëjetojnë me ta, të cilët nuk janë qytetarë apo banorë të përhershëm të Kosovës nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat e fituara nga puna e tyre për Korpusin e Paqes apo nga burimet e tjera jashtë Kosovës, nga të gjitha detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera për pronën e tyre personale të sjellë në Kosovë për përdorim vetjak dhe nga të gjitha taksat ose detyrimet e tjera (duke përfshirë edhe taksën e imigracionit/vizave) përveç taksave për licencat. Përveç kësaj, këtyre personave dhe anëtarëve të familjeve të tyre që bashkëjetojnë me ta do t'i jepet statusi i njëjtë me atë që i jepet personelit administrativ dhe teknik të misionit dipomatik të Shteteve të Bashkuara, me përjashtim se atyre nuk iu jepen imunitetet.
2. Kosova do t'i japë lejeqëndrimi dhe viza (përfshirë edhe vizë me shumë hyrje-dalje), pa asnjë pagesë apo detyrim tjetër, Përfaqësuesit të Korpusit të Paqes, stafit dhe individëve që kanë funksione sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre që bashkëjetojnë me ta.

NENI V

Kosova do të përjashtojë nga kërkesat për investimet dhe depozitim dhe nga kontrollet valutore të gjitha fondet e futura në Kosovë për përdorim në përputhje me këtë marrëveshje nga Shtetet e Bashkuara ose kontraktuesit që financohen prej tyre. Këto fonde do të shkëmbehen në valutën e Kosovës në vlerën më të lartë të kursit valutore që nuk është i jashtëligjshëm në Kosovë.

NENI VI

1. Përfaqësues të autorizuar të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës herë pas here mund të bëjnë përshtatje të caktuara lidhur me Vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe programet e Korpusit të Paqes në Kosovë sipas nevojës apo dëshirës me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Çdo kontest që rrjedh nga kjo marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga Shtetet e Bashkuara dhe Kosova.

NENI VII

Zotimet e Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës të cekura këtu varen nga fondet në dispozicion.

NENI VIII

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet kohë pas kohe me pëlqimin e përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës. Çfarëdo lloj ndryshimi do të bëhet me shkrim.

NENI IX

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri nëntëdhjetë ditë pas datës së lajmërimit me shkrim qoftë prej Shteteve të Bashkuara ose Kosovës drejtuar palës tjetër me synimin dhënien fund të marrëveshjes.

Nënshkruar në PRISHTINË më 09/09 2013, në dublikatë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Të tri tekstet janë barabar autentike. Në rast të mospërputhjes, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN
E KOSOVËS:

Nënshkruar nga:



Emri: Atifete Jahjaga
Titulli: Presidentë e Republikës së Kosovës

PËR SHTETET E
BASHKUARA TË AMERIKËS:

Nënshkruar nga:



Emri: Tracey Ann Jacobson
Titulli: Ambasadore e Shteteve të
Bashkuara në Republikën e Kosovës